



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.59

25 prill

2008

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Rezolutë e Kuvendit datë 17.4.2008	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2007	2607
Vendim i Kuvendit nr.180, datë 17.4.2008	Për emërimin e një anëtarit të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike	2608
Vendim i KM nr.418, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Fajzë të qarkut të Kukësit.....	2608
Vendim i KM nr.419, datë 8.4.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.111, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në përdorim të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Gjinaj të qarkut të Kukësit”.....	2609
Vendim i KM nr.420, datë 8.4.2008	Për disa ndryshime në vendimin nr.113, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në përdorim të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Golaj të qarkut të Kukësit”.....	2610
Vendim i KM nr.423, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Bërzhitë, të qarkut të Tiranës.....	2610
Vendim i KM nr.424, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Qendër Bulgarec, të qarkut të Korçës.....	2612
Vendim i KM nr.425, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës paraprake të pronave, të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, komunës	

	Fajzë, të qarkut të Kukësit	2613
Vendim i KM nr.429, datë 8.4.2008	Për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Vlerësimin e Masave për Importet.....	2614
Vendim i KM nr.431, datë 8.4.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Stebleva” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Steblevë”	2615
Vendim i KM nr.432, datë 8.4.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe bashkimit të shoqërive “Spahiu Gjanç” sh.p.k., “Fatjon”, sh.p.k., “SGA” sh.a., dhe “Armemil” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Lapaj”	2615
Vendim i KM nr.433, datë 8.4.2008	Për miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “ROT” (rehabilitim, operim, transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe shoqërisë “Ansara” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Labinot Mal-Elbasan” ...	2616
Vendim i KM nr.434, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës me numrat dhe titujt e standardeve të harmonizuara shqiptare, me karakter referues, për prezumimin e konformitetit të enëve të thjeshta nën presion	2616
Vendim i KM nr.435, datë 8.4.2008	Për miratimin e listës me numrat dhe titujt e standardeve të harmonizuara shqiptare, me karakter referues, për prezumimin e konformitetit të lodrave	2619
Vendim i KM nr.436, datë 8.4.2008	Për disa shtesa në vendimin nr.862, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e shoqërisë “Operatori i sistemit të shpërndarjes” sh.a.”	2620
Vendim i KM nr.438, datë 11.4.2008	Për lejimin e kalimit transit të pesë konvojeve ushtarake italiane dhe të një automjeti ushtarak slloven, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	2621
Vendim i KM nr.440, datë 16.4.2008	Për lejimin e kalimit transit të një konvoji ushtarak italian, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	2622
Vendim i KM nr.441, datë 16.4.2008	Për lejimin e kalimit transit të një kontingjenti ushtarak italian, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë	2623
Udhëzim i METE nr.250, datë 8.4.2008	Për zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.261, datë 27.2.2008 “Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të “Armo” sh.a.Tiranë dhe “Albpetrol” sh.a. Patos”	2624
Vendim i ERE nr.42, datë 11.4.2008	Për fillimin e procedurave për ndryshimin e licencës së shoqërisë “Dardania Energji” sh.p.k.....	2625
Vendim i ERE nr.43, datë 11.4.2008	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Musò Hec Qytezë” sh.p.k.....	2626

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE PËR VITIN 2007

Kuvendi i Shqipërisë,

- duke njohur dhe mbështetur rëndësinë e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për forcimin e demokracisë në Shqipëri, si institucioni kushtetues, i cili merret me përgatitjen, mbikëqyrjen, kontrollin, verifikimin e procesit zgjedhor, si dhe shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve;

- duke vlerësuar domosdoshmërinë e përmirësimit të funksionimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;

- duke mbajtur në konsideratë rekomandimet e institucioneve ndërkombëtare për kontributin e këtij institucioni në arritjen e standardeve për zhvillimin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike,

Konstaton se:

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2007 ka përmbushur detyrat e tij sipas Kodit Zgjedhor, në kushte të vështira, të krijuara si rezultat i tejkalimit të afateve ligjore zgjedhore, për shkak të vonesave që sollti miratimi i ndryshimeve në Kodin Zgjedhor dhe zbatimi i tij nga subjektet zgjedhore;

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka kryer detyrën e tij ligjore për zhvillimin e zgjedhjeve vendore të vitit 2007, me gjithë ndërhyrjet e forcave politike;

- transparenca për zgjedhjet e vitit 2007 ka qenë e plotë;

- ka mbajtur marrëdhënie të mira bashkëpunimi me institucionet shtetërore, partitë politike, institucionet ndërkombëtare dhe median;

- ka përdorur me efikasitet fondet e akorduara nga Buxheti i Shtetit për procesin zgjedhor.

Kuvendi kërkon nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për vitin 2008:

- respektimin e Kushtetutës, të legjislacionit zgjedhor dhe të rekomandimeve të organizmave ndërkombëtarë në të gjithë veprimtarinë e këtij institucioni;

- analizë të thellë dhe të plotë të të gjitha problematikave që sjellin proceset zgjedhore, për të identifikuar mangësitë ligjore dhe të infrastrukturës;

- fillimin e punës paraprake për përgatitjen e zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2009;

- vazhdimin e trajnimit dhe aftësimit të vijueshëm profesional të administratës zgjedhore;

- krijimin e një klime të përshtatshme bashkëpunimi e mirëkuptimi për zhvillimin e një procesi zgjedhor të lirë, të drejtë e të ligjshëm;

- ndërgjegjësimin e zgjedhësve për ushtrimin e së drejtës së tyre kushtetuese, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe standardet ndërkombëtare.

17 prill 2008

VENDIM
Nr.180, datë 17.4.2008

PËR EMËRIMIN E NJË ANËTARI TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ENTIT
RREGULLATOR TË SEKTORIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e Ekipit Përzgjedhës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Zoti Abaz Aliko emërohet anëtar i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.418, datë 8.4.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA,
QË DO TË TRANSFEROHEN NË PRONËSI TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE,
KOMUNA FAJZË TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, pyje dhe kullota, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ, të njësisë së qeverisjes vendore, komuna Fajzë të qarkut të Kukësit, që do t’i transferohen në pronësi kësaj njësie.

2. Lista përfundimtare e pronave të paluajtshme, pyje dhe kullota, me 4 (katër) fletë, që përfundon me numrin rendor 114 (njëqind e katërbëdhjetë), dhe lidhja 1 i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Fajzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
62-175	Pyll	Në pronësi

VENDIM
Nr.419, datë 8.4.2008

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.111, DATË 3.2.2008 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PËRDORIM TË NJËSISË SË QEVERISJES VENDORE, KOMUNA GJINAJ TË QARKUT TË KUKËSIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.111, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në titull dhe në pikën 1, fjalët “... në përdorim...” zëvendësohen me “... në pronësi...”.
2. Lidhja nr.1, që i bashkëlidhet vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe është pjesë përbërëse e tij.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
44-77,80-81,88-99,105-118,121-122,129-131-133,156,158-166,171-172,175-176,181-187,208-215,221-226,232-238,242-249,253-269	Pyje, kullota	Në pronësi

VENDIM
Nr.420, datë 8.4.2008

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.113, DATË 3.2.2008 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE, PYJE
DHE KULLOTA, QË DO TË TRANSFEROHEN NË PËRDORIM TË NJËSISË SË
QEVERISJES VENDORE, KOMUNA GOLAJ TË QARKUT TË KUKËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, dhe të nenit 23 të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe të Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.113, datë 3.2.2008 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në titull dhe në pikën 1, fjalët “... në përdorim...” zëvendësohen me “... në pronësi...”.
 2. Lidhja nr.1, që i bashkëlidhet vendimit, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe është pjesë përbërëse e tij.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Njësia e qeverisjes vendore: komuna Golaj

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
494-945	Pyje, kullota, infrastrukturë	Në pronësi

VENDIM
Nr.423, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
KOMUNËS BËRZHITË TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Bërzhitë të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Bërzhitë të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.302, datë 24.5.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Bërzhitë, të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Bërzhitë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Bërzhitë

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
49,50	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën administratës	Në pronësi
35-47	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
31-34	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
1,2	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
3-30	Varrezat publike	Në pronësi
338-390	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
393-408	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
284-315	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
316-325	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka jo produktive)	Në pronësi
440	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi

VENDIM
Nr.424, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË
KOMUNËS QENDËR BULGAREC TË QARKUT TË KORÇËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Qendër Bulgarec, të qarkut të Korçës, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Qendër Bulgarec, të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.163, datë 25.3.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Qendër Bulgarec, të qarkut të Korçës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qendër Bulgarec për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna: qendër Bulgarec

Lidhja 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
4-30	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
58-70	Prona që përdoren në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
85-102	Prona që përdoren për strehim dhe mbrojtje civile	Në pronësi
1,2,3,31-57	Prona që përdoren në fushën kulturore sportive	Në pronësi
103-116	Shërbim funeral	Në pronësi
182,186,187,189-217	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, troje të zëna) dhe shërbime publike	Në pronësi
71-81	Prona që përdoren në fushën e infrastrukturës, troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çfarëdolloji	Në përdorim

325,326,329,331,333,336, 338,340,341,342,344,345,34 6,348,349,350	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
229,253,277,285,295,302,31 2,315,320,327,328,330, 332,334,335,337,339,343, 347	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka inproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
351-363	Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm	Në pronësi

VENDIM
Nr.425, datë 8.4.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS FAJZË TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Fajzë, të qarkut të Kukësit, sipas lidhjes 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Fajzë, të qarkut të Kukësit, miratuar me vendimin nr.356, datë 20.5.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Fajzë, të qarkut të Kukësit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Fajzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendore të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-10	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
11-15	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
16-50	Varreza publike	Në pronësi
51-53	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
176-183	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
224-229	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi

VENDIM
Nr.429, datë 8.4.2008

PËR EMËRIMIN E ANËTARËVE TË KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E MASAVE PËR IMPORTET

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 e 5 të ligjit nr.9790, datë 19.7.2007 “Për masat mbrojtëse në importe”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Emërimin e anëtarëve të komisionit për vlerësimin e masave për importet, si më poshtë vijon:

Z. Genc Ruli, Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
Znj. Anila Jani, Drejtore e Drejtorisë së Mbikëqyrjes së Tregut në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;

Z. Endrit Lami, Drejtor i Drejtorisë së Makroekonomisë në Ministrinë e Financave;
Z. Grigor Gjeçi, Drejtor i Drejtorisë së Politikave Rurale në Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit;

Z. Genci Muçaj, Drejtor i Promovimit Ekonomik dhe Kulturor në Ministrinë e Punëve të Jashtme;

Znj. Lindita Xhillari, Drejtore e Departamentit Juridik dhe të Shërbimeve në Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë;

Z. Genc Çeli, Drejtor i Drejtorisë së Statistikës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

2. Anëtarët e komisionit janë kryesisht juristë dhe/ose ekonomistë.

3. Çdo anëtar i komisionit për vlerësimin e masave për importet të shpërblehet me 5 000 (pesë mijë) lekë për pjesëmarrje në mbledhje, por masa e shpërblimit mujor nuk duhet të jetë më

shumë se 5 000 (pesë mijë) lekë.

4. Sektori i antidumpingut, pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ushtron funksionet e sekretariatit teknik gjatë procesit të hetimit dhe të punës së komisionit për vlerësimin e masave për importet.

5. Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.431, datë 8.4.2008

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT” (NDËRTIM, OPERIM DHE TRANSFERIM), TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “STEBLEVA” SHPK, PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “STEBLEVË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “Stebleva” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Steblevë”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.432, datë 8.4.2008

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “BOT” (NDËRTIM, OPERIM DHE TRANSFERIM), TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE BASHKIMIT TË SHOQËRIVE “SPAHIU GJANÇ” SHPK, “FATJON” SHPK, “SGA”, SHA, DHE “ARMEMIL” SHPK PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “LAPAJ”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe

bashkimit të shoqërive “Spahiu Gjanç” sh.p.k., “Fatjon” sh.p.k., “SGA” sh.a. dhe “Armemil” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Lapaj”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.433, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT, TË FORMËS “ROT”
(REHABILITIM, OPERIM, TRANSFERIM), TË LIDHUR NDËRMJET MINISTRISË SË
EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS DHE SHOQËRISË “ANSARA” SHPK,
PËR NDËRTIMIN E HIDROCENTRALIT “LABINOT MAL-ELBASAN”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 4, e 27 të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit, të formës “ROT” (rehabilitim, operim, transferim), të lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoriteti kontraktues, dhe shoqërisë “Ansara” sh.p.k., për ndërtimin e hidrocentralit “Labinot Mal-Elbasan”, sipas tekstit dhe anekseve, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.434, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS ME NUMRAT DHE TITUJT E STANDARDEVE TË
HARMONIZUARA SHQIPTARE, ME KARAKTER REFERUES, PËR PREZUMIMIN E
KONFORMITETIT TË ENËVE TË THJESHTA NËN PRESION**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 2 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e listës me numrat dhe titujt e standardeve të harmonizuara shqiptare, që i bashkëlidhen këtij vendimi, të cilat do të shërbejnë si dokumente reference, për prezumimin e konformitetit të enëve të thjeshta nën presion, sipas kërkesave thelbësore, të përcaktuara në vendimin nr.889, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të enëve të thjeshta nën presion”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA SHQIPTARE QË KANË KARAKTER REFERUES PËR PREZUMIMIN E KONFORMITETIT TË ENËVE TË THJESHTA NËN PRESION, SIPAS VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.889, DATË 19.12.2007

Nr.	Referenca dhe titulli i standardit të harmonizuar	Viti i adoptimit si standard shqiptar S SH	Mënyra e adoptimit (me faqe të parë, Fp, ose me përkthim të plotë Pp)
1.	S SH EN 286-1:1998 Enë të thjeshta në presion rezistente ndaj zërit, që shërbejnë për mbajtjen e ajrit ose të azotit -Pjesa 1: Enët në presion për përdorim të përgjithshëm	2003	Fp
	S SH EN 286-1:1998/A1:2002	2003	Fp
	S SH EN 286-1:1998/A2:2005	2007	Fp
	S SH EN 286-1:1998/AC:2002	2007	Fp
2	S SH EN 286-2:1992 Enë të thjeshta në presion të lartë, pa ngrohje, për mbajtje azoti dhe ajri – Pjesa 2: Enë në presion të lartë për frena me ajër dhe sisteme ndihmëse për automjete me motor dhe për rimorkiot e tyre	1997	Fp
	S SH EN 286-2:1992/AC:1992	2007	Fp
3	S SH EN 286-3:1994 Enët e thjeshta nën presion që nuk i ekspozohen zjarrit, të destinuara të mbajnë ajër dhe azot- Pjesa 3: Enët nën presion prej çeliku, të destinuara për pajisje frenimi me ajër dhe pajisje pneumatike ndihmëse për lokomotiva dhe vagonë hekurudhorë	2003	Fp
4	S SH EN 286-4:1994 Enët e thjeshta nën presion që nuk i ekspozohen zjarrit, të destinuara të mbajnë ajër dhe azot-Pjesa 4: Enët nën presion prej lidhjeje alumini, të destinuara për pajisje frenimi me ajër dhe pajisje pneumatike për lokomotiva dhe vagonë hekurudhorë	2003	Fp
5	S SH EN 287-1:2004 Prova miratuese për saldatorë-Saldimet me shkrirje- Pjesa 1: Çeliqet	2007	Fp
	S SH EN 287-1:2004/A2:2006	2007	Fp
	S SH EN 287-1:2004/AC:2004	2007	Fp
6	S SH EN 571-1:1997 Provat pa shkatërrim-Provat me depërtim-Pjesa 1:Parime të përgjithshme	2001	Fp
7	S SH EN 583-1:1998 Prova pa shkatërrim. Kontrolli ultrasonik-Pjesa 1: parime të përgjithshme	2002	Fp
8	S SH EN 970:1997 Kontrolli pa shkatërrim të saldimit me shkrirje – Kontrolli pamor	2007	Fp

9	S SH EN 1011-1:1998 Saldimi-Rekomandime për saldimin e materialeve metalike-Pjesa 1: Udhëzim i përgjithshëm për saldimin me hark	2000	Fp
10	S SH EN 1290:1998 Provat pa shkatërrim të saldimeve-Provat e saldimeve me grimca magnetike	2006	Fp
11	S SH EN 1330-3:1997 Provat pa shkatërrim-terminologjia-Pjesa 3. Termat që përdoren në provat industriale radiografike	2002	Fp
12	S SH EN 1714:1997 Provat pa shkatërrim të saldimeve-Provat ultrazanore të bashkimeve të salduara	2000	Fp
13	S SH EN ISO 6520-1:1998 Proceset e saldimit dhe bashkimeve të përhershme - Klasifikimi i defekteve gjeometrike në materialet metalike-Pjesa 1: Saldimi me shkrirje	2003	Fp
14	S SH EN 10207:2005 Çelique për enë në presion të thjeshtë-Kushtet teknike të furnizimit të fletëve, shiritave dhe shufrave prej çeliku	2007	Fp
15	S SH EN 12062:1997 Provat pa shkatërrim të saldimeve-Rregulla të përgjithshme për materialet metalike	2000	Fp
16	S SH EN ISO 15614-1:2004 Specifikimi dhe kualifikimi i procedurave të saldimit për materiale metalike-Prova e kualifikimit të procedurës së saldimit-Pjesa 11:Saldimi me rreze elektronesh dhe rreze lazer	2007	Fp
17	S SH EN ISO 15614-2:2005 Specifikimi dhe kualifikimi i procedurave të saldimit për materiale metalike-Prova e kualifikimit të procedurës së saldimit-Pjesa 2:Saldimi me hark i aluminit dhe lidhjeve të aluminit	2007	Fp

VENDIM
Nr.435, datë 8.4.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS ME NUMRAT DHE TITUJT E STANDARDEVE TË
HARMONIZUARA SHQIPTARE, ME KARAKTER REFERUES, PËR PREZUMIMIN E
KONFORMITETIT TË LODRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 19 të nenit 2 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e listës, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me numrat dhe titujt e standardeve të harmonizuara shqiptare, të cilat do të shërbejnë si dokumente reference, për prezumimin e konformitetit të lodrave, sipas kërkesave thelbësore, të përcaktuara në vendimin nr.888, datë 19.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të lodrave”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E STANDARDEVE TË HARMONIZUARA SHQIPTARE QË KANË KARAKTER
REFERUES PËR PREZUMIMIN E KONFORMITETIT TË LODRAVE, SIPAS VENDIMIT TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.888, DATË 19.12.2007**

Nr.	Referenca dhe titulli i standardit të harmonizuar	Viti i adoptimit si standard shqiptar S SH	Mënyra e adoptimit (me faqe të parë, Fp, ose me përkthim të plotë Pp)
1	S SH EN 71-1:2005 Siguria e lodrave-Pjesa 1: Vetitë mekanike dhe fizike	2005	Fp
	S SH EN 71-1:2005/A3:2006	2007	Fp
	S SH EN 71-1:2005/AC:2006	2007	Fp
	S SH EN 71-1:2005 + A4:2007	2007	Fp
2	S SH EN 71-2:2006 Siguria e lodrave-Ndezshmëria	2006	Fp
	EN 71-2:2006/AC:2006	2006	Fp
3	S SH EN 71-3:1994 Siguria e lodrave-Pjesa 3: Migrimi i disa elementeve	1994	Fp
	S SH EN 71-3:1994/A1:2000	2007	Fp
	S SH EN 71-3:1994/A1:2000/AC:2000	2007	Fp
	S SH EN 71-3:1994/AC:2002	2007	Fp
4	S SH EN 71-4:1990	1999	Fp

	Siguria e lodrave-Pjesa 4: Seritë eksperimentale për kiminë dhe aktivitetet që kanë lidhje me të		
	S SH EN 71-4:1990/A1:1998	2005	Fp
	S SH EN 71-4:1990/A2:2003	2007	Fp
	S SH EN 71-4:1990/A3:2007	2008	Fp
5	S SH EN 71-5:1993 Siguria e lodrave-Pjesa 5: Lodrat kimike (seritë me përjashtim të serisë eksperimentale)	1999	Fp
	S SH EN 71-5:1993/A1:2006	2007	Fp
6	S SH EN 71-6:1994 Siguria e lodrave-Pjesa 6:Simbolet grafike për etiketën e kohës së përdorimit	1999	Fp
7	S SH EN 71-7:2002 Siguria e lodrave-Pjesa 7: Ngjyruetit e gishtave të dorës-Kërkesat dhe metodat e provës	2005	Fp
8	S SH EN 71-8:2003 Siguria e lodrave-Pjesa 8: Kolovajset, rrëshqitëset dhe lodrat për aktivitet të njëjtë për t'u përdorur nga familjarët brenda dhe jashtë shtëpisë	2005	Fp
	S SH EN 71-8:2003/A1:2006	2007	Fp
9	S SH EN 62115:2005 Lodrat elektrike-Siguria (IEC 62115:2003 + A1:2004 (i modifikuar)	2007	Fp

VENDIM
Nr.436, datë 8.4.2008

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.862, DATË 20.12.2006 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES”, SHA”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, dhe të ligjit nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.862, datë 20.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 5 shtohen:

“... me përjashtim të pjesës së detyrimeve, që lidhen me huatë/kreditë afatgjata nga donatorët e huaj, që janë, disbursuar dhe materializuar, dhe që do të materializohen në të ardhmen si pjesë e aseteve të OSSH sha-së, në kuadër dhe në zbatim të projekteve e të marrëveshjeve përkatëse me kreditorët e huaj, sipas të cilave KESH sh.a.-ja do të mbetet në rolin e kredimarrësit ose të nënkredimarrësit, kur kredimarrëse është qeveria.”.

2. Pas pikës 5 shtohen pikat 5/1 e 5/2, me këtë përmbajtje:
“5/1 Asetet në administrim të KESH sh.a.-së, që i kalojnë Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH), sha, të regjistrohen në pronësi të këtij operatori.

5/2. Pronësia e aksioneve të OSSH sh.a.-së, transferohet nga KESH sh.a.-ja, te Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me urdhër të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.438, datë 11.4.2008

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË PESË KONVOJEVE USHTARAKE ITALIANE
DHE TË NJË AUTOMJETI USHTARAK SLOVEN, PËRMES TERRITORIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes së kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit të 1 (një) konvoji ushtarak italian, të përbërë nga 6 (gjashtë) automjete dhe 12 (dymbëdhjetë) trupa, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 12 prill 2008.

2. Lejimin e kalimit transit të 1 (një) konvoji ushtarak italian, të përbërë nga 5 (pesë) automjete dhe 10 (dhjetë) trupa, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 15 prill 2008.

3. Lejimin e kalimit transit të 1 (një) konvoji ushtarak italian, të përbërë nga 5 (pesë) automjete dhe 10 (dhjetë) trupa, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 17 prill 2008.

4. Lejimin e kalimit transit të 1 (një) konvoji ushtarak italian, të përbërë nga 16 (gjashtëmbëdhjetë) automjete dhe 26 (njëzet e gjashtë) trupa, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 17 prill 2008.

5. Lejimin e kalimit transit të 1 (një) konvoji ushtarak italian, të përbërë nga 6 (gjashtë) automjete dhe 12 (dymbëdhjetë) trupa, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datën 18 prill 2008.

6. Lejimin e kalimit transit të 1 (një) automjeti ushtarak sloven, me personel, 2 (dy) trupa ushtarake slovene, i ngarkuar me armë, mjete dhe pajisje ushtarake, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datat 23-25 prill 2008.

7. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të

shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

8. Konvojet italiane dhe automjeti ushtarak sloven, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohen nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

9. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.440, datë 16.4.2008

PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË NJË KONVOJI USHTARAK ITALIAN, PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit të një konvoji ushtarak italian, të përbërë nga 14 (katërmëdhjetë) automjete dhe 22 (njëzet e dy) trupa, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Qafë-Thanë-Porti i Durrësit, në datën 21 prill 2008.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë dhe pika e daljes është Porti i Durrësit.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave, nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Konvoji ushtarak italian, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohet nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.441, datë 16.4.2008

**PËR LEJIMIN E KALIMIT TRANSIT TË NJË KONTINGJENTI USHTARAK ITALIAN,
PËRMES TERRITORIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 16, pika 2, 17, 18 e 19 të ligjit nr.9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaj në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, me propozimin e Ministrisë së Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e kalimit transit të një kontingjenti ushtarak italian, të përbërë nga 26 (njëzet e gjashtë) trupa të armatosura dhe 13 (trembëdhjetë) automjete, përmes territorit të Republikës së Shqipërisë, në itinerarin Porti i Durrësit-Qafë-Thanë, në datat 16-17 prill 2008.

Pika e hyrjes në territorin e Republikës së Shqipërisë është Porti i Durrësit dhe pika e daljes është pika e kalimit të kufirit Qafë-Thanë.

2. Procedurat për hyrjen, qëndrimin dhe daljen e këtyre trupave në/nga Republika e Shqipërisë janë parashikuar në marrëveshjen, ndërmjet palëve të Traktatit të Atlantikut të Veriut, për statusin e forcave nënshkruar në Londër, më 19 qershor 1951, të marrëveshjes, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe shteteve të tjera, që marrin pjesë në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre, nënshkruar në Bruksel, më 10 janar 1994, si dhe të protokollit shtesë për marrëveshjen, ndërmjet shteteve palë në Traktatin e Atlantikut të Veriut dhe të shteteve të tjera, pjesëmarrëse në Partneritetin për Paqe, përsa i përket statusit të forcave të tyre”, ratifikuar me ligjin nr.8034, datë 22.11.1995.

3. Kontingjenti ushtarak italian, gjatë itinerarit të lëvizjes nëpër territorin e Republikës së Shqipërisë, të shoqërohet nga njësi të armatosura të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

4. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.250, datë 8.4.2008

PËR ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR.261, DATË 27.2.2008
“PËR TRAJTIMIN E PUNONJËSVE QË DALIN TË PAPUNË NGA PROCESI I
RISTRUKTURIMIT TË “ARMO” SHA TIRANË DHE “ALBPETROL” SHA PATOS”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës dhe pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.261, datë 27.2.2008 “Për trajtimin e punonjësve që dalin të papunë nga procesi i ristrukturimit të “Armo” sh.a. Tiranë dhe “Albpetrol” sh.a. Patos”

UDHËZOJ:

1. Shoqëritë “Armo” sh.a. Tiranë dhe “Albpetrol” sh.a. Patos, në përputhje me legjislacionin në fuqi ngarkohen të kryejnë ristrukturimin e fuqisë punëtore. Drejtoritë e shoqërive Armo” sh.a. Tiranë dhe “Albpetrol” sh.a. Patos të bashkërendojnë punën me Shërbimin Kombëtar të Punësimit të Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, për fillimin dhe vazhdimin normalisht të procedurave të trajtimit të punonjësve që dalin të tepërt nga ristrukturimi.

2. Punonjësit e shoqërive “Armo” sh.a. Tiranë dhe “Albpetrol” sh.a. Patos, që dalin të papunë si pasojë e ristrukturimit të këtyre shoqërive, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.261, datë 27.2.2008, në zbatim të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, përfitojnë trajtim si më poshtë:

- Shpërblim deri në një vit pagë, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.

- Shpërblimi për vjetërsi është të paktën sa paga e një 15-ditëshi, mbi çdo vit pune të plotë, që llogaritet në bazë të pagës që ekziston në përfundim të marrëdhënieve të punës. Kur paga është e ndryshueshme, shpërblimi llogaritet mbi mesataren e pagës së vitit paraardhës dhe indeksohet. Shpërblimin për vjetërsi e përfitojnë punonjësit që janë në marrëdhënie pune me këto shoqëri jo më pak se tre vjet pa ndërprerje.

3. Për trajtimin e punonjësve sipas pikave 1, 2, 3, 4, e 6 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.261, datë 27.2.2008 për periudhën njëvjeçare të pagesës procedohet:

- Pagesa e punonjësve, që përfitojnë sipas pikës 1 dhe 3, fillon nga data kur punonjësit dalin të papunë dhe realizohet nga zyra përkatëse e punësimit vetëm pas paraqitjes së listave të punonjësve nga “Armo” sh.a. Tiranë dhe “Albpetrol” sh.a. Patos. Në këtë pagesë nuk përfshihen shtesat mbi pagë.

- Në zbatim të pikës 2, personat përfitues kanë të drejtën e trajtimit me pagesë papunësie pas përfundimit të trajtimit sipas këtij vendimi.

Në zbatim të pikës 4, çdo person është i detyruar të paraqesë vërtetim nga dega e tatimeve të rrethit ku ka vendbanimin. Personat që vetëpunësohen ose punësohen gjatë periudhës së trajtimit sipas këtij vendimi duhet të bëjnë deklaratë në zyrën e punësimit për të ndërprerë pagesën; në të kundërt detyrohen të zhdëmtojnë shumën e përfituar padrejtësisht.

- Për të përfituar të drejtën e trajtimit sipas kriterëve të këtij vendimi, punonjësit që dalin të papunë duhet të paraqesin në zyrën përkatëse të punësimit këto dokumente:

- Librezën e punës, ku të shkruhet shkaku i ndërprerjes: “Dalë i papunë nga ristrukturimi i shoqërive “Armo” sh.a. Tiranë ose “Albpetrol” sh.a. Patos, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.261, datë 27.2.2008;

Libreza e punës të jetë e firmosur dhe vulosur nga ish-punëdhënësi, drejtori i drejtorisë së përgjithshme/rajonit/zonës/filialit të shoqërive “Armo” sh.a. Tiranë ose “Albpetrol” sh.a. Patos,

pranë të cilit ka qenë i punësuar punonjësi përkatës.

-Vërtetim nga organet tatimore të rrethit, ku të shënohet nëse punonjësi kryen ose jo aktivitet privat;

- Certifikatën e gjendjes familjare.

- Pagesat për punonjësit realizohen me listëpagesa të veçanta në datat që përcaktohen nga zyra e punësimit, e cila nga ana e saj harton dhe listëpagesat e veçanta për çdo periudhë. Një kopje të këtyre listëpagesave zyra e punësimit ia dërgon drejtorisë së përgjithshme/rajonit/zonës/filialit të shoqërive “Armo” sh.a. Tiranë ose “Albpetrol” sh.a. Patos jo më vonë se 5 ditë të punueshme përpara datës së caktuar për pagesën e punonjësve.

- Në rast mosparaqitjeje të përfituesit në datën e caktuar, paga e tij arkëtohet jo më vonë se brenda 5 ditëve, duke filluar nga dita e kryerjes në fakt të pagesave.

4. Në zbatim të pikës 6, fondet e nevojshme për kompensimin e punonjësve dhe detyrimet për sigurimet shoqërore e shëndetësore, përpara përfundimit të procesit të privatizimit, të mbulohen nga likuiditetet e shoqërive “Armo” sh.a. Tiranë ose “Albpetrol sh.a. Patos. Për këtë qëllim drejtoria e përgjithshme/rajonit/zona/filiali të shoqërive “Armo” sh.a. Tiranë ose “Albpetrol” sh.a. Patos, brenda dy ditëve të punueshme nga data e marrjes se listëpagesave, të transferojë fondin në degën e thesarit të çdo rrethi, për llogarinë e zyrës së punësimit.

5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen shoqëritë “Armo” sh.a. Tiranë, “Albpetrol” sh.a. Patos.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
DHE ENERGETIKËS
Genc Ruli

VENDIM
Nr.42, datë 11.4.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR NDRYSHIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË
“DARDANIA ENERGJI” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 15 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 4.4.2007, dhe nenit 18, pika 1, germa “f”, të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.4.2008, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “En-Ku” sh.p.k., për transferimin e licencës së shoqërisë “Dardania Energji” sh.p.k., konstatoi paraqitjen e plotë të dokumentacionit, sipas kërkesave të neneve 8 dhe 9 të rregullores së procedurave të licencimit, dhe shprehjen juridikisht të vullnetit të shoqërisë “Dardania Energji” sh.p.k. për kryerjen e ndryshimeve në licencën e lëshuar kësaj shoqërie,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për ndryshimin e licencës nr.10 seria PV03P, lëshuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.20, datë 19.12.2003, shoqërisë “Dardania Energji” sh.p.k.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë “En-Ku” sh.p.k. dhe “Dardania Energji” sh.p.k. për këtë vendim të Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

VENDIM
Nr.43, datë 11.4.2008

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “MUSO HEC QYTEZË” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pikat 1, germa “a”, dhe 8, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 18, pika 1, germa “a”, dhe nenit 38, të Rrregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin nr.44, datë 24.7.2007, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.4.2008, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Muso Hec Qytezë” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga Hec Qytezë,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “Muso Hec Qytezë” sh.p.k. në aktivitetin e ndërtimit dhe prodhimit të energjisë elektrike nga Hec Qytezë.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- | | |
|--|-----------|
| 1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË | 600 lekë |
| 2. REGJISTRAT E NOTERISË | 1000 lekë |

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL	210 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE	332 lekë
KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)	542 lekë
KODI CIVIL	408 lekë
KODI I PROCEDURËS CIVILE	224 lekë
KODI I PUNËS	138 lekë
KODI I FAMILJES	244 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	88 lekë
• Vendime të Gjykatës Kushtetuese	700 lekë
• Vendime të Gjykatës së Lartë	1000 lekë
• Përmbledhje legjislacioni për nëpunësin civil	200 lekë
• Përmbledhje legjislacioni në fushën e tatimeve dhe taksave	273 lekë
• Përmbledhje e legjislacionit për pasuritë e paluajtshme (Vol. I -192 lekë; Vol. II – 168 lekë, Vol. III – 185 lekë)	

Hyri në shtyp më 23.4.2008
Doli nga shtypi më 25.4.2008

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 24 lekë